

Data _____

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Krburant për vitin 2024”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Karburante 09100000-0

VLERA E FONDIT LIMIT:

11.543.279 (njembedhjet milion e pesqind e dyzet e tre mijë e dyqin e shtatdhjet e nente)
lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Fondi i Sigurimit të Detyrueshem të Kujdesit Shendetesor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 8.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77 pika 3 i LPP, si dhenenin 43 pika 2, gërma "b" të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Përcaktimi i vlerës dhe i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore, argumentohet si vijon: Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues, i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

1. Operatori ekonomik, duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparëshme, të ngjashme, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2021-2022-2023) nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Realizimi i furnizimeve të ngjashme, duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë:

- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e shërbimeve ose faturat tatimore të shitjes;

Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes ku të jenë shënuar datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1/gërma "c" të Ligjit nr.162, dt.23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenin 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2. Subjekti ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjisllacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë përgjatë vitit të fundit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma ”c”, dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Rrepublicën e Shqipërisë”, si dhe ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, për transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

Ky kriter është i rëndësishëm, pasi garanton që Operatori Ekonomik ofron çilesi duke respektuar standardet Ligjore si dhe respekton normat dhe te gjitha masat mbrojtese duke ofruar produkt sipas standarteve bashkekohore. Vertetimi i leshuar nga ky institucion na siguron që ofrohet furnizim çilesor si dhe operatori ekonomik ofertues zbaton kushtet e parashikuara ne lejet apo autorizimet perkatese per ushtrimin e aktivitetit.

3. Operatori ekonomik oferues, duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën **ISO 9001:2015 ose ekuivalente**, lidhur me sistemet me menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme.
4. Operatori ekonomik ofertues, duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën **ISO 14001:2015 ose ekuivalente**, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila përfshin objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme.

Argumentimi: Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë të vlefshme ne kohen e zhvillimit te procedures së prokurimit. Çertifikata e mësipërme duhet të jenë në gjuhën shqip ose të jenë të përkthyer në shqip, si dhe origjinale ose të njehsuara me origjinalin (kopje të noterizuar). Çertifikatat duhet të jenë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ne rastet kur oferta dorezohet nga nje BO, operatorët duhet te disponojne certifikatat e kerkuara në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

5. Operatori ekonomik ofertues, duhet të jetë i pajisur me, Akt teknik, të lëshuara nga PMNZH, Policë sigurimi, të lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve, për despozitat e tregtimit me shumicë, që vërteton kapacitetet depozituese dhe rezervat e Operatorit ekonomik për të garantuar vazhdimësinë e furnizimit sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, ”Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të

tyre”, të ndryshuar, në ligjin nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion“. Në lidhje me kriterin e lejes mjedisore kjo kërkesë është referuar ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, i ndryshuar me ligjin nr. 60/2014, “Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 152 datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, të ndryshuar,

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me kërkesat mjedisore duke garantuar reduktimin, minimizimin apo shmangin e ndikimeve në mjedis të instalimeve ndotëse, duke respektuar standartet kombetare. Akti teknik lëshuar nga PMNZH është i rëndësishëm, pasi tregon që operatori ekonomik ofertues ka marre masa dhe vepron në përputhje me legjislacion Shqiptar. Kërkesa për pajisjen e OE me police sigurimi për përgjegjësinë e palëve të treta është vendosur në zbatim të VKM nr.1047, datë 16.7.2008, pika 7, ku përcaktohet “Shoqëritë e pajisura me leje tregtimi ose autorizim, brenda 30 ditëve nga data e pajisjes, duhet të kryejnë sigurimin e përgjegjësisë ligjore për dëmet, që mund t’u shkaktohen palëve të treta, për shkak të ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë”

6. Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 1 pikë karburanti në territorin e Bashkisë Tiranë. Pikat e karburantit duhet të jenë të pajisuara me Vërtetim Teknik të lëshuar nga ISHTI, Leje mjedisore të lëshuar nga QKL, dhe policë sigurimi lëshuar nga shoqërite e sigurimeve, që operojnë në Republikën e Shqipërisë. Kjo kërkesë duhet vertetuar me një nga format e disponimit, sipas Kodit Civil (kontratë qiraje, noteriale ose akt pronsie, të pasqyruara në ekstraktin tregtar të shoqërisë).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162 dt. 23.12.2020 ‘Për prokurimin publik’, nenit 40, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri që OE duhet të deklarojë me shkrim është bërë duke patur parasysh destinacionet në funksion të zbatimit të detyrave funksionale.

7. Operatori ekonomik duhet të sigurojë shpërndarje në të gjitha Akset Kryesore Rrugore të vendit, të paktën një pikë karburanti, përgjatë segmentit rrugor. Për këtë, Operatori Ekonomik, duhet të dorëzojë një deklaratë, ku të jenë përcaktuar qartë adresa dhe vendodhja e pikave të karburantit, shoqëruar me dokumentacionin ligjor që provon disponimin e tyre (të jenë të rregjistruara në QKB dhe të shoqërohen me akt pronësie ose kontratë qiraje, etj), sipas Akseve Rrugore ose dhe në qytetet e përcaktuara si më poshtë:

- Tiranë - Durrës
- Tiranë – Kamëz – Lezhë - Shkodër
- Tiranë – Elbasan – Pogradec - Korçë
- Tiranë – Fier - Vlorë

- Fier - Gjirokastrë - Sarandë
- Tiranë - Lushnje - Berat
- Tiranë - Kukës
- Kukës - Tropojë
- Tiranë – Dibër

Për këto pika operatori duhet të paraqesë kontratë qeraje ose vërtetim pronësie, vërtetim teknik, dhe policë sigurimi.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162 dt. 23.12.2020 ‘Për prokurimin publik’, nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri që OE duhet të deklarojë me shkrim është bërë duke patur parasysh destinacionet në funksion të zbatimit të detyrave funksionale dhe duke patur parasysh se Fondi prokurone karburant dhe per drejtorite rajonale qe ndodhen ne Rethë.

8. Operatori Ekonomik duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë, me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor dhe me bot, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Argumentim Kriteri i mësipërm vendoset në mbështetje të pikës 8 të nenit 40 të VKM- së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Ky vetdeklarimit i nevojitet autoritetit kontraktor për tu garantuar nga ana e operatorit ekonomik të suksesshëm që do të sigurojë vijueshmëri në furnizimin e mallit, përgjatë gjithë periudhës së kantatës pa nxjerrë pengesa.

9. Bazuar në VKM-në nr. 561 datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qeverisjes së përgjithshme” Operatorët Ekonomik pjesmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi (Webpage) ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryeht nëpërmjet kartës elektronike. Faqja e menaxhimit të karburanteve duhet të ofrojë edhe shërbimin për krijimin e strukturës piramidale në përputhje me strukturën piramidale të Autoritetit Kontraktor, shërbimin e

furnizimit me karburant nëpërmjet kartave elektronike të cilat ofrojnë shërbimin e furnizimit me karburant vetëm për automjetet. Disponimi/ekzistenca e faqes së menaxhimit së bashku me ofrimin e shërbimeve të kërkuara mësipër do të demonstrohen nga Operatori Ekonomik.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe ligjit Nr.9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 561, datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesite e qeverisjes së përgjithshme”, ... etj.

10. Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë se Malli/ karburanti, do të ofrohet me karta elektronike të personalizuar në të gjitha pikat e karburantit ose me autobot sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë furnizim sa herë ta ketë të nevojshme duke e realizuar këtë kërkesë me shkrim në mënyrë zyrtare.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe ligjit Nr.9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 561, datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesite e qeverisjes së përgjithshme”, ... etj.

11. Operatori Ekonomik ofertues, duhet të paraqesë deklaratë me shkrim se furnizimi i mjeteve do të jetë e mundur të realizohet çdo ditë të javës brenda 24 orëve në të gjithë distributorët e furnizuesit dhe në pistoletë publike. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë furnizim sa herë ta ketë të nevojshme.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

12. Me paraqitjen e kërkesës nga autoriteti kontraktor, kontraktuesi është i detyruar të furnizojë autoritetin kontraktor në kohë dhe sasinë e kërkuar duke përfshirë në çmimin e tyre gjithë detyrimet fiskale që ka shteti shqiptar.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SPRCIFIKIMET TEKNIKE

GAZOIL (10 ppm)

Gazoili analizohet sipas standartit **S SH EN 590 : 2022**

Nr	Treguesit	Njësia matjes	Kufijtë		Rezultati
			Minimum	Maksimum	
1	Numri i cetanit		51.0		
2	Indeksi i cetanit		46.0		
3	Densiteti ne 15 °C	Kg/m ³	820,0	845,0	
4	Hidrokarburet aromatik policiklike	% m/m	-	8,0	
5	Permbajtja e sqfurit	mg/kg		10,0	
6	Pika e flakërimit	°C	55	-	
7	Mbetja e karbonit (ne 10 % mbetje distilimi)	% m/m	-	0,30	
8	Permbajtja e hirit	% m/m	-	0,010	
9	Pika e bllokimit te filtrit ne te ftohte CFPP	°C			
10	Korrozioni ne shufer bakri (3 ore ne 50 °C)	vleresim	Klasa 1		
11	Permbajtja e esterit metilik te acidit yndyror (FAME)	% v/v	-	7,0	

12	Viskoziteti ne 40°C	mm ² /s	2,00	4,50	
13	Distilimi :				
	Distilati qe vlon deri ne 250°C, % (v/v)	% v/v	-	< 65	
	Distilati qe vlon deri ne 350°C, % (v/v)	% v/v	85		
	95 % (v/v) distilon ne	°C		360	

BENZINE 95 OKTAN

Benzina analizohet sipas standartit S SH EN 228 : 2018

Nr	Treguesit	Njesia matjes	Kufijte		Rezultati
			Minimum	Maksimum	
1	Numri i oktanit kerkimor NOK		95		
2	Numri i oktanit motorrik NOM		85		
3	Densiteti ne 15 °C	kg/m ³	720,0	775,0	
4	Permbajtja e squfurit	mg/kg	-	10,0	
5	Korozioni i shufres se bakrit (3 ore / 50 °C)	Renditje	Klasa 1		
6	Tensioni i avujve	kPa			
7	Pamja e jashtme		E paster dhe e tejdukshme		
8	Destilimi				
a	Distilon deri 70 °C	% v/v	20	48	
b	Distilon deri 100 °C	% v/v	46,0	71,0	
c	Distilon deri 150 °C	% v/v	75	-	
d	Pika finale e distilimit	°C	-	210	

e	Mbetjet e distilimit	% v/v	-	2	
9	Permbajtja e tipit te hidrokarburit				
a	Olefinat	% v/v	-	18,0	
b	Aromatiket	% v/v	-	35,0	
10	Permbajtja e benzenit				
		% v/v	-	1,0	
11	Permbajtja e oksigjenit				
		%(m/m)	-	2,7	
12	Permbajtja e komponimeve oksigjenore				
a	Methanol (alkool metilik)	% v/v	-	3	Perzierja ne vellim i kufizuar ne 2.7 % (m/m) te permbajtjes maksimale te oksigjenit
b	Etanol (alkool etilik)			5	
e	Alkool terc - butil				
f	Komponime oksigjenore te tjera				
g	Etere (me 5 ose me shume atome C)				

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

NJËSIA E PROKURIMIT

Arian Karroçi Ergan Dollani Fabiola Ribaj